

## PRODUKTET TRADICIONALE TË BAXHOVE

Në Shqipëri ka rreth 420 stabilimente të përpunimit të qumështit. Nga këto 330 stabilimente, ose 80% e numrit total, kanë kapacitete përpunuese të vogla 500 - 2,000 litra qumësht në ditë. Rreth 220 stabilimente përpunojnë djathë nga qumështi i deleve dhe i dhive në mënyre të thjeshtë duke përdorur teknologji tradicionale dhe operojnë me sezone. Kushtet e higjenës së këtyre baxhove kërkojnë përmirësim të standardeve.

## ÇFARË JANË KËRKESAT QË UDHËZOHEN NGA BE-ja

Udhëzuesi i Sistemit të plotë të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore (FSMS) i përbërë nga disa pjesë, thekson veçanërisht:

1). **“Praktikat e mira të higjenës” (GH) dhe “Praktikat e mira të prodhimit” (GMP).** Në prodhimin e djathit dhe produkteve të tjera të qumështit, menaxhimi i këtyre praktikave të mira është thelbësor për të kontrolluar rrezikun e paraqitur nga rreziqet përkatëse, duke siguruar një bazë për zbatimin efektiv të planeve të bazuara në HACCP.

2). **Procedura e bazuar në HACCP, duke përfshirë:** - **“Analizat e rrezikut”.** Ky seksion detajon rreziqet kryesore kimike, fizike dhe mikrobiologjike që kanë të bëjnë me produktet e qumështit duke renditur ato më të rëndësishmet.

Kushtet në ambjentet përpunuese duhet të respektojnë:

- **Ruajtja dhe transporti i qumështit.** Qumështi ruhet në tankera, por është e mundur të përdoren edhe mjete të tjera, si kova të mbyllura hermetikisht të cilat mund të ruhen në frigorifer. Kushtet e transportit duhet të respektohen.

- **Hapësirë për punëtorinë dhe tualete.** Duhet të sigurohet një zonë e caktuar për ndërrimin e veshjeve të punëtorëve. Veshjet mbrojtëse duhet të ruhen në mënyrë që të parandalohet kontaminimi (p.sh. varëse, dollapë, etj.). Këpucët e jashtme duhet të zëvendësohen ose dezinfektohen përpara se të hyjnë në zonat e prodhimit të ushqimit. Duhet të sigurohet një numër i mjaftueshëm tualetesh me ujë.

- **Zonat e trajtimit të ushqimit:** prodhimi, maturimi, ftohja, paketimi dhe shitja duhet të respektojnë skemën teknologjike dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që të sigurohet lehtësia e pastrimit dhe të zvogëlohet rreziku i kontaminimit.

- **Muret dhe dyshemetë** duhet të jenë të lëmuara, të papërshkueshme dhe të lehta për t'u pastruar. Materialet e përshtatshme mund të përfshijnë pllaka ose panele plastike.

## “PËRPUNUES QUMËSHTI NË BAXHO, INVESTONI TANI PËR TË ARRITUR STANDARDET E KËRKUARA NË LIGJ”

Nga vlerësimi i kryer në terren 60-70% e baxhove kanë nevojë për investime në plotësimin e kriterëve kombëtare dhe ato minimale që kërkon BE-ja. Këto investime mesatarisht arrijnë vlerat e 6,000,000-7,000,000 lekë dhe financohen fare lehtë nga institucioni NOA.

## “NOA FINANCON, NOA KËSHILLON”

7 Gusht 2023

